

# ETNOGRAFIA SHQIPTARE NË KOHË NË FILATELINË SHQIPTARE

Fjorel ÇOMO, Brunilda OZUNI  
Studiuesë, Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Nëse sot ato mijra pulla shqiptare do ti vendosnim në një shirit fotografik një vend të veçantë në emetimet e serive të pullave shqiptare një rol të rëndësishëm në filatelinë shqiptare zënë të gjitha emisionet me tematikë mbi etnografinë shqiptare. Për herë të parë etnografia shqiptare në filatelinë shqiptare shfaqet në periudhën pas çlirimit të vendit. Në periudhën e viteve 1945-1990 tematika e pullave shqiptare është shumë më e gjerë dhe mjaft e larmishme se tematika para viteve 1945. Tashmë në këto vite për hir edhe të interesave pragmatiste, ideologjike dhe politike, ajo filloj të gjejë një terren gjithnjë e më të madh, tematika mbi historinë shqiptare që siç dihet përfaqëson edhe një fond etno-kulturor shumë të rëndësishëm dhe me ndikim si faktor aktiv për të mënjanuar rrezikun e shkombëtarizimit.

*Fjalë kyce: filateli, pulla shqiptare, etnografia, kostumet popullore, vallet popullore, festivalet folklorik, veglat muzikore, banesa karakteristike, pikturat, kostumet kombëtare.*

## ABSTRACT

Albanian Philately has treated Albanian Ethnography and its constituent branches as a precious treasure in its 109-year journey. The wide range of series broadcast throughout the years and on the theme of Albanian Ethnography with Folk Costumes, Folk Dances, National Folk Ensembles, Folk Festivals, Musical Instruments, Paintings and Characteristic Dwellings of our country as a whole constitute an ensemble and treasure of Albanian Ethnography as one of the most important elements in defining our national identity.

*Key words: philately, albanian stamps, ethnography, national costumes, traditional dancing, folk festival, traditional instruments, characteristic dwellings, paintings, national costumes.*

## THESARET E FOLKLORIT SHQIPTAR U PËRÇUAN EDHE NË EMETIMET POSTARE

Thesaret e folklorit shqiptar u përçuan edhe në emetimet postare. Për herë të parë tematika mbi etnografinë shqiptare u shfaq në filatelinë shqiptare në vitin 1959 me emisionin e posaçëm kushtuar javës së monumenteve të kulturës, me tri vlera me të njëjtën pamje, por me ngjyra të ndryshme në formatin 24 x 33 mm.



*Fig. - 1 Java e Monumenteve*

Më datën 28 Prill 1961 u hodh në qarkullim një emisjon me katër vlera me veshje kombëtare. Kjo tematikë në mënyrë të veçantë ju kushtua veshjeve kombëtare të zonës së veriut ku në vlerën e parë dhe të tretë paraqitet veshja e një burri nga zona e Malësisë së Madhe (Shkodër) dhe Lumë ndërsa në vlerën e dytë dhe të katërt paraqitet veshja e një gruaje nga zona e Malësisë së Madhe (Shkodër) dhe Lumë.



*Fig. - 2 Kostumet Kombëtare 1959*

Vetëm një vit më pas në vitin 1962 Posta Shqiptare hedh në qarkullim serinë në dy lloj variantesh me tematikë kostumet kombëtare të trevave lindore dhe jugore të Shqipërisë. Në vlerën e parë të saj paraqitet veshja e një gruaje nga zona e Dardhës ndërsa në vlerën e dytë të saj paraqitet Kostumi Popullor i burrave të zonës së Devollit. Në vlerën e tretë të saj paraqitet gruaja Lunxhote dhe në vlerën e fundit të saj kostumi popullor i veshjes së burrave në Gjirokastrë.



*Fig. – 3 Kostumet Kombëtare (dhëmbëzim) 1961*

Për efekte filatelike kjo seri paraqitet edhe në varjantin e dytë si seri e pa dhëmbëzuar.



*Fig. – 4 Kostumet Kombëtare (pa dhëmbëzim) 1961*

Pas këtij viti Posta Shqiptare do të emetonte një cikël emisionesh të tjera të realizuara estetikisht në këtë fushë. Në vitin 1967 Posta Shqiptare hodhi në qarkullim një seri filatelike me 8 vlera me tematikë Kostumet Kombëtare të zonës së Malësisë së Madhe, Zadrimës, Kukësit, Dardhës, Myzeqesë, Tiranës, Dropullit, dhe Labërisë.



*Fig. – 5 Kostumet Kombëtare 1967*

Në 20 Gusht të vitit 1977 emetohet seria me tematikë ‘Vallet Popullore’ e cila punohet mjeshtërisht nga një prej kryemjeshtrave të pikturës shqiptare Naxhi Bakalli, e cila shënon dhe serinë e parë të pikturuar prej tij në filatelinë shqiptare. Punimet e tij të begata me larmishmërinë e trajtimit të tematikave të trajtuara nga ky piktor qofshin në rrafshin historik qoftë dhe në rrafshin etnografik janë thesare në pullën shqiptare. Burimi kryesor i frymëzimit të tij mbetet krijimtaria popullore.



*Fig. – 6 Vallet Popullore 1977*

Krahas vizatimeve Naxhi Bakalli ka një arsenal të tërë bocetash të pullave me ngjyra. Në to peneli i tyre u ka dhënë formë deri sfumaturave më të lehta. Subjekte të tilla si maskat, veglat muzikore legjendat e Kostandinit dhe të Doruntinës, Gjergj Elez Alisë, Rozafa apo Legjenda e Ohrit, Festalet Folklorike të Gjirokastrës 1978, 1983 dhe 1988 shquhen përmes ndjeshmërisë dhe thellësisë së mendimeve edhe për realizimin estetik nëpërmjet ujdísjes së ngjyrave të përmbajtura.





*Fig. – 7 Veglat Muzikore*



*Fig. – 8 Kostumet Kombëtare në Vallet Popullore 1977*



*Fig. - 9 Kostumet Kombëtare në Vallet Popullore 1978*





*Fig. – 10 Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 1978*



*Fig. – 11 Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 1983*



*Fig. – 12 Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrë 1988*





*Fig. - 13 Ansamblet tona jashtë shtetit 1983*



*Fig. - 14 Folklori Shqiptar – Gjergj Elez Alia 1990*



*Fig. – 15 Folklori Shqiptar – Legjenda Kostandini dhe Doruntina*



Fig. - 16 Kostumet Kombetare-2001



Fig. - 17 Kostumet Kombetare -2002



Më 28 – 30 Qershor 1978 në Tiranë, zhvillohet Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike. Me rastin e kësaj ngjarjeje Posta Shqiptare hedh në qarkullim një pullë të syrsazhuar (mbishtypur) e cila qëndron në qarkullim vetëm për 1 muaj duke e klasifikuar këtë pullë një prej më të rrallave në një tirazh prej 8100 copë.

Pjesë e Etnografisë Shqiptare janë dhe pikturat apo pejsazhet me tematikë nga vendi jonë. Në mënyrë të veçantë do të përmendja Kol Idromenon. Kol Idromeno është një nga përfaqësuesit e mëdhenj dhe një nga figurat më të shquara të Rilindjes Kombëtare. Në pikturë Idromeno ka krijuar kompozime të karakterit etnografik, ka realizuar portrete me vlera të ralla, ku përmendet portreti i ‘Motrës Tone’ (1883), i cili mund të cilësohet si një nga peisazhet më të parë të pikturës shqiptare. Për të përkujtuar këtë figurë poliedrike të artit, Posta Shqiptare ka emetuar në vitin 1967 dy pulla me veprat e tij ‘Motra Tone’ dhe ‘Dasma Shkodrane’.



*Fig. – 18 Një pullë postare dhe incidenti diplomatik*

Në vitet 80 fillojnë kryengritjet e popullit shqiptar të Kosovës, ku në mënyrë të padrejtë fuqitë e mëdha i japin Jugosllavisë të drejtën asaj për ta kolonizuar. Në muajin Mars dhe Korrik të vitit 1981 Posta Shqiptare ju përgjigj, duke emëtuar një seri pullash me ngjarje e momente historike të trojeve shqiptare



*Fig. - 19 Punime Artizanati 1981*





*Fig. – 20 Artet Figurative-1981*

Në 20 shkurt 1982, 40 vjet përpara, pasoi emëtimi i serisë “Shtëpitë karakteristike të vëndit tonë”, të autorit Bujar Zajmi. Situata e tensionuar shoqëruar dhe nga demonstratat e fuqishme të shqiptarëve të Kosovës me kërkesën “Kosova Republikë”, ngjarje të cilat u zhvilluan në harkun kohor nga muaji Mars e vazhdim të vitit 1981 kishin krijuar një situatë jo të qetë për Jugosllavinë. Nga fillimi i vitit 1981, marrëdhënjet ndërmjet dy shteteve ishin tejet të tensionuara, me akuza e kundërakuza, replika në të cilat përfshiheshin shumë institucione.

*Fig. – 21 Shtëpi Karakteristike-1979*

Situata në këto kohë ishte mjaft e nderë dhe sikur të mos mjaftonte pafundësia e akuzave dhe shpifjeve, këtyre ju shtua edhe emëtimi i serisë së pullave postare të Shqipërisë, të vëna në qarkullim në shkurtin e vitit 1982, në sportelet postare. Serite më tematikë Banesat kishin filluar që në vitin 1979, me një seri prej 5 pamjesh të autorit Bujar Zajmi. Një prej tyre kishte emërtimin “Kullë në malësi të Gjakovës”, por seria mbartëte titullin “Shtëpi karakteristike të fshatit” dhe “Malësi Gjakove”.



Nëse në rastin e serisë së muajit korrik 1981 dhe të kësaj të vitit 1979, nuk dihet të ketë patur reagim, me këtë serinë e vitit 1982 historia rrodhi ndryshe. Në qarkoren e Drejtorisë së Përgjithshme të Postave e Telekomunikacioneve të Shqipërisë, një botim ky që shoqëronte çdo emëtim të ri e dhe që kryesisht u drejtohej blerësve dhe koleksionistve, cilësohej se “Posta Shqiptare do të emëtojë në muajin shkurt 1982 një emision pullash, me pamje nga shtëpitë karakteristike të vëndit tonë”.

Seria përbëhej nga 4 vlera që shfaqnin banesa karakteristike në Bulqizë, në Rrafshin e Dukagjinit të Kosovës (Lebush), në Bicaj dhe në Klos të Matit. “Veçantia e kësaj serie ka të bëjë, kur një prej këtyre pullave tregonte një banesë në Lebush të Kosovës, territor që shtrihej jashtë kufijve shtetërorë, u bë shkak për mbërritjen shumë shpejt në dyert e Ministrisë së Punëve të Jashtme e një



note proteste të Federatës Jugosllave. Qarkullimi i kësaj pulle, me vlerë 80 qindarka që përbënte shërbimin postar të letrës së rregjistruar brënda vendit, ju mbingarkua klimës së tejnxehët dhe të acaruar tashmë midis dy vëndeve.

Pavarësisht kësaj, Posta Shqiptare nuk e ndali punën e saj dhe vazhdojë me tematikën nga Kosova. Fill dy muaj pas notës së protestës ajo emëtoi dhe hodhi në qarkullim një seri tjetër pullash me pamje nga Kosova. Seria përbëhej nga 4 vlera nominale prej 25 Qindarka, 80 Qindarka, 1.20 Lekë dhe 1.55 Lekë. Pamjet kishin piktura të piktorve G. Madhi e K.Buza, në të cilat shfaqeshin hijshëm Gryka e Rugovës, Prizreni dhe Peja.



*Fig. – 22 Shtepite karakteristike shqiptare-1982*

Emisioni i pullave postare shqiptare, në qarqet politike e diplomatike të Federatës Jugosllave, u interpretua si provokacion e pretendim territorial. Sidoqoftë, vitet kaluan, incidenti “u harrua“, Jugosllavia u shkatërrua ndërsa pullat me banesat karakteristike të vëndit tonë, skicime shumëngjyrëshe të piktorit Bujar Zajmi, ngelën e zënë një vënd të dukshëm në albumet e filatelistve.

## **PËRFUNDIME**

1. Si përfundim mund të themi se Filatelia Shqiptare e ka trajtuar Etonografine Shqiptare dhe degët përbërëse të saj si një thesar të çmuar në rrugëtmin e saj 109 vjeçar.
2. Gama e gjerë e serive të emëtuara gjatë gjithë viteve e në vazhdim me tematikë Etnografia Shqiptare me Kostumet Popullore, Vallet Popullore, Ansamblet Popullore Kombëtare, Festalet Folklorike, Veglat Muzikore, Pikturat si dhe Banesat Karakteristike të vëndit tonë në tërësi përbëjnë një ansambël dhe thesar të Etnografisë Shqiptare si një prej elementeve më të rëndësishëm në përcaktimin e identiteti tonë kombëtar.

## **STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA**

1. Revista Kolesionisti nr. 5
2. Revista Koleksionisti nr 13
3. Revista Kolesionisti 37